

AKT THEMELIMI

“EBCONS” SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë “**EBCons**” **SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si “shoqëria”, e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “**SHPK**”.

2. Ortaku i shoqërisë

Ortak të shoqërisë janë: Znj.Bjona Ziaj shtetas shqiptar, i datëlindjes 16.12.1989, banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal I96216052F, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe Znj. Erinda Xhaferaj i datëlindjes 16.06.1989, banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal I95616062Ë.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Aktivitet në fushën e konsulencës financiare, fiskale dhe manaxheriale;
- Ngritja, përmirësimi dhe strukturimi i shoqërive operuese në industri të ndryshme;
- Ngritja, përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemeve kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike si dhe trajnimin profesional të personelit që është ngarkuar me funksionimin e këtyre sistemeve;
- Përgatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave të drejtuesve të biznesit;
- Përgatitja e planeve të biznesit për nevojat e drejtuesve dhe për palët e treta, rivlerësim aktivitetesh, këshillime biznesi mbi mundësitë e zhvillimit, këshillime për fillim aktiviteti tregtar;
- Organizimi i kurseve të trajnimit profesional në fushën e kontabilitetit, financës e të administrit finansiar;
- Konsulenza në lidhje me transformimet dixhitale të proceseve të shoqërive operuese në indsutri të ndryshme;
- Konsulencë në lidhje me manaxhimin e fondeve të donatorëve të huaj, shkrime projektesh, asistencash teknike dhe ekspertiza.
- Ndërmjetësim, menaxhim, konsulencë për lidhjen e marrëveshjeve midis institucioneve shtetërore, personave juridikë vendas dhe të huaj, shtetërorë dhe privatë për financim, hartim dhe zbatimin e projekteve në fushën e Consimeve, të industrisë, turizmit, infrastrukturës, telekomunikacionit, energjitetikës, mjedisit, bujqësisë, shëndetësisë, arsimit, sportit, arkeologjisë, hidroteknikës, ndërtimit hidroçentrale dhe Hartimi i studimeve, projekteve, zbatimi i tyre, në

fushën e ndërtimeve civile, industriale, turistike, telekomunikacionit, Aeroportit, energjistikës, mjeshterit, bujqësisë, shëndetësisë, arsimt, kulturës, sportit, arkeologjisë, ndërtimeve civile, ndërtimi rrugësh, kanalesh, ura, ujësjellës, kanalizimeve, impjante vadite, vepra arti të çdo lloji, hidrocentrale dhe termocentrale, rikonstruksioni i godinave dhe objekteve të çdo lloji të rëndësisë ekonomike e sociale.

- Çdo aktivitet tjetër të lidhur me sa më sipër dhe në përputhje me legjislacionet përkatëse.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. **Selia e shoqërisë**

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: "Hyrja 2, Pallati 7/1, Rruga Ismail Qemali, Tiranë".
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistonë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. **Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 10,000 (dhjetë mijë lekë).
- Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale
 - ALL 5,000 (pesë mijë lekë), 50% që zotërohet nga znj. Erinda Xhaferaj;
 - ALL 5,000 (pesë mijë lekë), 50% që zotërohet nga znj. Bjona Ziaj.

7. **Organet vendimmarrëse të shoqërisë**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rrinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është: **Znj. Bjona Ziaj**, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 16.12.1989, e identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal I96216052F.

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

Datë 16.01.2024

ORTAKËT E SHOQËRISË

Erinda Xhaferaj

Bjona Ziaj